

Konflikti i interesit

Leksioni 1, Konflikti i Interesit – Përkufizimet dhe Simptomat.....	2
Leksioni 2, Konflikti i Interesit – Organet e specializuara	15
Leksioni 3, Raste studimore	18

Leksioni 1, Konflikti i Interesit – Përkufizimet dhe Simptomat

Si pjesë e parimeve të debateve për qeverisjen e mirë, terma si “korrupsioni”, “konflikti i interesave”, “transparenca”, “përgjegjshmëria”, etj., janë aq të zakonshme dhe të automatizuara sa njerëzit që i përdorin ato rrallë mendojnë për kuptimet aktuale të fjalëve. Ne shpesh gjendemi në situata të vështira kur nuk kemi kufij të qartë të këtyre “etiketimeve”, prandaj edhe vlera e tyre mbetet ideologjike dhe jo praktike. Kjo do të thotë që ne flasim plot bujari e pasion për korrupsion ose konfliktin e interesit në fushata politike apo veprimtari të ngjashme, por kjo ka pak vlerë kur duhet të zbulohet situata e konfliktit të interesit ose të demaskohen zyrtarët e korruptuar. Kështu, kemi ardhur në pyetjen kryesore të kësaj hyrjeje: Çfarë është konflikti i interesave?

Në kontekste të ndryshme termi do të marrë kuptime të ndryshme, por ka disa tipare të përgjithshme që shënjojnë fenomenin “konflikt interesi”. Enciklopedia Ligjore Amerikane West (West’s Encyclopedia of American Law) e përshkruan atë si:

Situata në të cilën një zyrtar publik ose i besuar që, përkundër detyrimit dhe detyrës për të vepruar në të mirë të publikut ose të një personi të caktuar, e shfrytëzon marrëdhënien për përfitime personale, përgjithësisht ekonomike. (Lehman dhe Phelps, 2005: 84)

Ky përshkrim thekson faktin se konflikti i interesit në përgjithësi lidhet me pozicionet ku delegohet besimi publik ose privat. Individët në pozicione të tilla ballafaqohen me sfidën për të marrë vendime në pikën ku ky interes i jashtëm i besuar potencialisht mund të përplasë ose në të vërtetë ndeshet me të drejtat e tyre private. Shkurtimisht është një “detyrë profesionale kundër arsyes private”. Perceptimi i përgjithshëm mund të jetë se situata të tilla janë tipike për administratën publike (në rastin tonë në qeverisjen vendore), por në praktikë ato mund të shfaqen në shumë vende të tjera dhe marrëdhëniet e interesit të ndërsjellë në konflikt mund të jenë më komplekse. Për shembull, një firmë ligjore mund të mbrojë interesin e një qytetari kundër një kompanie, por një nga avokatët mund të jetë aksioner në kompaninë që pritet të përballë në gjykatë. Nga ana tjetër, firma e avokatit në fjalë mund të ofrojë shërbime ligjore edhe për një institucion shtetëror, i cili është gjithashtu palë e interesuar në procesin gjyqësor mes qytetarit dhe kompanisë, mund të ketë marrëdhënie familjare mes pjesëmarrësve në rast, duke e komplikuar atë në pafundësi, duke qenë që një gjë e tillë nuk është aq e rrallë në realitet.

Duke e reduktuar kompleksitetin e jetës së vërtetë në simptoma të përgjithshme dhe lehtësisht të identifikueshme, studiuesit (Trost dhe Gash, 2008: 23) bëjnë një përmbledhje të parakushteve kryesore për një situatë të konfliktit të interesit në një formulë, që përmban atë që kemi nxjerrë tashmë nga përkufizimi i gjerë:

a. posti me pushtet

b. përfitime kundërshtuese / private dhe publike

Kësaj ata i shtojnë një element të detyrës etike ose ligjore, gjë që është e rëndësishme, sepse në praktikë udhëzimi “etik” është një instrument mjaft i rëndësishëm i kodeve të sjelljes dhe

manualeve procedurale në administratë. Sipas kësaj logjike bashkëpunimi vullnetar i zyrtarëve vendimmarrës shihet si i vetmi mjet efektiv për parandalimin dhe shmangien e konfliktit të interesit. Zyrtarët duhet të jenë proaktive, duke kaluar mënjatë vullnetarisht për të neutralizuar konfliktet e mundshme të interesit:

c. detyrimi për të lënë postin /sa herë që një situatë e tillë është e pranishme /

Për të zgjeruar perspektivën, na duhet të prezantojmë një tjetër dimension të konfliktit të interesit, që e dallon atë nga deviacionet e tjera që lidhen me pushtetin.

d. kushtëzimi

Kjo do të thotë se ndryshe nga korrupsion, që duhet të zbulohet vetëm në veprat e abuzimit me pushtetin dhe besimin, konflikti i interesit mund të ekzistojë në forma “latente”, pa ndonjë shkelje të veçantë apo shfaqje të drejtpërdrejtë, pra jo një veprim, por një mundësi. Sipas kësaj vije mendimi, dallohen tre lloje të konfliktit të interesit (shih OECD, 2003: 58).

i. *konflikt i mundshëm i interesit*: Nëpunësi civil është në gjendje financiare, familjare ose personale që mund të përballet në disa momente të ardhshme me detyrat e tij publike. Zhvillimi në karrierë, kalimi në poste më të larta apo ngritja në detyrë janë shembuj tipikë të pikave të tilla të kthimit. Siç theksojnë ekspertët e etikës, konflikti i mundshëm nuk ka ndonjë konotacion negativ. Nëse krijohet një konflikt i mundshëm interesi, atëherë duhet të ushtrohet “kujdes i duhur” (N. C. Bordi i Etikës, 2006).

ii. *konflikt në dukje i interesit*: është gjendja, në të cilën interesat private të zyrtarit duken, në pamje ose në formë, sikur kanë ndikuar, ndikojnë ose mund të ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave apo përgjegjësi të tij zyrtare, por, në fakt, ndikimi nuk ka ndodhur, nuk ndodh ose nuk ka mundësi të ndodhë. Ky është rasti ku kërkohet të rritet transparenca, sepse nuk ka shkelje edhe pse dyshimi i bën shumë dëm besimit të publikut tek administrata.

iii. *konflikt faktik i interesit*: Është situata kur interesat private të zyrtarit tashmë janë në konflikt me interesin publik, të cilin personi në fjalë është i detyruar të mbrojë. Ne flasim për një situatë aktuale, duke u zhvilluar në të tashmen. Shembull tipik këtu është rasti kur anëtari i një komisioni vlerësimi po vlerëson një ofertë për një tender ose një projekt, të paraqitur nga një person i afërm apo tjetër ‘i lidhur’ me të.

Përveç këtyre tipareve të përgjithshme që e karakterizojnë atë, konflikti i interesit mund të gjendet në kontekste të ndryshme dhe ‘të kapur’ në forma të caktuara. Disa sektorë, për shkak të marrëdhënieve, bazuar në delegimin e besimit, diskutohen në literaturë si më të prirur për situata të tilla: profesioni ligjor, profesioni mjekësor, biznesi (p.sh. Moore et al., 2005) dhe shërbimi publik. Për sa i përket shfaqjeve konkrete, duhet të theksojmë se këto janë të vështira për t’u tipologjizuar, sepse situatat nga jeta reale janë të pakufizuara. Gjithsesi, në literaturë bashkëkohore bëhen përpjekje për të dhënë disa kualifikime bazë: Agjencia e Mjekëve të Sistemit Shëndetësor të Austrisë përcakton llojet e mëposhtme konfliktit të interesave: a) përfitimi nga ata ose ajo që dini (duke përdorur marrëdhëniet familjare dhe marrjen me hile të informacionit); b) ndikimi i padrejtë (ndikimi tek bordet dhe organet e tjera vendimmarrëse); c) gjykimi i komprometuar ose marrja e vendimeve në mënyrë të kompromentuar (interesi personal

ndeshet me detyra personale për t'i shërbyer interesit publik) (AHPRA, 2012). Një këndvështrim tjetër dallon midis konfliktit nga poshtë-lart: kur dikush përdor postin e tij për të konsoliduar një pozitë më të lartë të pushtetit - p.sh. emërimi i kandidatëve të “duhur” në bordin që pritet të kontrollojë vendimet e tij (“zaptimi”); dhe, (b) konflikti nga lart-poshtë: kur një person përdor pushtetin që i është deleguar për të përmbushë qëllimet e tij private (Trost dhe Gash, 2008): 24).

Me interes të veçantë janë situatat e konfliktit të interesit që krijohen gjatë kalimit nga sektori publik në atë privat. Shpesh zyrtarë të lartë publikë, pasi kanë lënë pozicionin e tyre, shkojnë në sektorin privat, ku ata mund të përfitojnë në mënyrë të konsiderueshme nga njohuritë, rrjetet dhe lidhjet që kanë krijuar gjatë kohës së tyre në pushtet. Ky lloj kalimi quhet me termin “punësim pas lënies së detyrës”. Paradoksi i përfshirjes në situatë të konfliktit të interesit pasi është lënë posti me pushtet përshkruhet me metaforën “Fenomeni i derës me hapje nga të dy krahët” (Bertók, 2010). Ilustrimi mekanik na jep një ide të shkëlqyer për lëvizjen shumëdimensionale: nga administrata në biznes dhe nga biznesi në administratë. Ndonjëherë në ekuacionin mund të shohim edhe kalime të tilla mes degëve të ndryshme të pushtetit - një deputet i cili ka lobuar për një legjislacion të caktuar mund të marrë një post në ekzekutiv dhe bëhet përgjegjës për zbatimin e këtij legjislacioni.

Për ta përmbledhur me pak fjalë: njohuritë dhe literatura rreth konfliktit të interesave po rritet vazhdimisht, të nxitur nga kryqëzata globale e qeverisjes së mirë. Situatat ku rastet aktuale mbyten nga mjegulla e një diskutimi konceptual pa fund bëhen krejtësisht të mundshme. Cilët janë elementët e “konfliktit të interesit” që mund të përdoren nga një organizatat vendore të shoqërisë civile me burimet e tyre të kufizuara për të bërë një diagnozë të shpejtë të situatave të konfliktit të interesit? Së pari: të dyshuarit kryesorë janë postet me pushtet. Së dyti, duhet të zbulohet interes personal bazuar në prova.

Konfliktet e interesit- Receta dhe Rregulla

Për të kontrolluar konfliktet e mundshme dhe aktuale të interesit brenda radhëve të tyre, kompanitë dhe administratat kanë krijuar protokolle të posaçme. Në nivel shteti këto protokolle kanë marrë formën e ligjeve. Ky është rasti në pjesën më të madhe të vendeve anëtare të BE-së (Denmke et al., 2007: 10). Nuk ka një politikë të centralizuar në të gjithë Bashkimin Evropian: i) nga njëra anë, rregullat e veçanta e ulin rrezikun në institucionet e ndryshme evropiane, ii) nga ana tjetër, në direktivat sektoriale trajtohen çështjet të fushave të ndryshme ekonomike; dhe, së treti, iii) – kemi regjimet specifike sipas shtetit.

i) Rregullat për shmangien e konfliktit të interesit të detyrueshme në Parlamentin e BE-së dhe Komisionin

Parlamenti Evropian

Parimet. Që nga janari i vitit 2012 anëtarët e Parlamentit Evropian janë të detyruar nga Kodi i ri i Sjelljes që të deklarojnë interesat financiare dhe të marrin leje për çdo aktivitet që ka mundësi të shkaktojë një konflikt interesi për anëtarin. Disa parime janë formuluar që në pjesën hyrëse të dokumentit:

- **mungesa e interesit,**
- integriteti, hapja

- zelli,
- ndershmëria,
- përgjegjshmëria dhe
- respekti për reputacionin e Parlamentit.

Deputetët janë të detyruar të veprojnë vetëm në interes të publikut dhe të mos kërkojnë përfitime financiare ose ndonjë përfitim tjetër. Dokumenti jep shpjegim të mëtejshëm të këtij detyrimi - ata duhet: 1) “të mos votojnë në interes të ndonjë personi tjetër juridik ose fizik”; 2) “të mos kërkojnë, pranojnë ose marrin ndonjë përfitim financiar të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ose shpërblim tjetër në këmbim të ushtrimit të ndikimit, ose duke votuar personin juridik ose fizik” dhe 3) “të shmangë çdo situatë që mund të nënkuptojë ryshfet apo korrupsion”.

Përkufizimi dhe procedura. “Konflikti i interesit” përcaktohet sipas linjave standarde: një interes personal që mund të ndikojë në mënyrë të pahijshme në kryerjen e detyrave publike. Në këtë rast parashikohet një protokoll i veçantë: 1) Pas vendosjes së konfliktit, deputetët duhet ta zgjidhin vetë atë, 2) Nëse ai nuk është në gjendje ta zgjidhë këtë konflikt, atëherë problemi duhet t’i referohet Presidentit me shkrim, 3) Në raste paqartësie, deputeti mund të kërkojë këshilla në mirëbesim nga Komiteti Këshillimor për Sjelljen e Anëtarëve (neni 3). 4) Deklarimi i situatave të konfliktit të interesit duhet t’i bëhet e ditur me shkrim ose me gojë kryetarit të seancës para se të flitet ose të votohet në seancë plenare. 5) Në fund të seancës së parë pas zgjedhjeve në Parlamentin Evropian (ose brenda 30 ditëve nga marrja e detyrës në Parlamentin gjatë mandatit parlamentar) anëtarët e parlamentit duhet të dorëzojnë një deklaratë me shkrim të interesave financiare tek Presidenti i Parlamentit.

Deklarata sipas pikës 5) më sipër përmbajnë informacionin e mëposhtëm (siç përshkruhet në Nenin 4, 2):

Përmbajtja e Deklaratës

(A) Profesioni: profesioni i anëtarit gjatë periudhës tre vjeçare para se ai ose ajo të marrë detyrën në Parlament dhe anëtarësia e tij gjatë asaj periudhe në borde ose komitete të shoqërive, organizatave joqeveritare, shoqatave ose organeve të tjera të themeluara me ligj,

(b) Paga parlamentare: çdo pagë që anëtari merr për ushtrimin e një mandati në një parlament tjetër,

(c) Shpërblime të rregullta: çdo aktivitet i rregullt me pagesë që Anëtari merr përsipër së bashku me ushtrimin e detyrës së tij, qoftë si i punësuar ose si person i vetëpunësuar,

(d) Anëtarësia: anëtarësimi në ndonjë bord ose komision të ndonjë kompanie, organizate joqeveritare, shoqata ose organe të tjera të themeluara me ligj, ose ndonjë aktivitet tjetër të jashtëm që anëtari merr përsipër, qoftë edhe nëse anëtarësia ose veprimtaria në fjalë shpërblehet ose nuk shpërblehet,

(e) shpërblime sipas rastit: çdo aktivitet i jashtëm rastësor por që paguhet (përfshirë shkrime, leksione ose dhënien e këshillave prej eksperti), nëse shpërblimi i përgjithshëm i kalon 5,000 euro në një vit kalendarik,

(f) Aksionet: çdo zotërim aksionesh në çdo shoqëri ose ortakëri, ku ekzistojnë implikime të mundshme të politikës publike ose kur këto aksione i japin anëtarit një ndikim të rëndësishëm tek punët e organit në fjalë,

(g) Mbështetja e jashtme: çdo mbështetje, qoftë financiare ose me staf apo materiale, përveç atij të dhënë nga Parlamenti, që i jepet anëtarit në lidhje me aktivitetet e tij politike nga palët e treta, identiteti i të cilave do të duhet të bëhet i ditur;

(h) të tjera: interesa të tjera financiare

Parashikohen disa kategori “shumash”, ku deputetët duhet të klasifikojnë të ardhurat e tyre mujore jashtë pagës që marrin nga Parlamenti Evropian:

- 500 – 1,000 euro
- 1,001 – 5,000 euro
- 5000 – 10,000 euro
- mbi 10,000 euro

Parlamenti i BE mban një regjistër me informacione të mbledhura gjatë procedurës. Ky regjistër është në dispozicion për lexim në zyrat e Parlamentit në Bruksel dhe Strasburg. Nga ana tjetër, deklaratat individuale janë të aksesueshme në faqet personale të vetë deputetëve. Nëse deputetët nuk kanë bërë dhe dorëzuar deklaratat e tyre, atyre nuk u lejohet të kenë detyra në Parlament, të bëhen raportues ose anëtarë të delegacioneve të Parlamentit. Në këtë rast, shumica e funksioneve të tyre përfaqësuese janë të pezulluara.

Përveç çështjeve financiare, Kodi i Sjelljes trajton edhe blerjet jo-monetare të deputetëve - dhurata dhe përfitime të tjera. Neni 5 i Kodit ndalon marrjen e çdo prone me një vlerë prej më shumë se 150 euro “gjatë kryerjes së detyrave të tyre.” Dhuratat e pranuar nën këtë prag duhet t'i dorëzohen Presidentit.

Në një dispozitë të veçantë merren parasysh konfliktet e mundshme të interesit që mund të shfaqen në periudhën pas mandatit parlamentar kur ish-deputetët zhvillojnë karrierën e tyre në biznesin e konsulencës (lobimit). Megjithatë, rregullorja është paksa e paqartë dhe tolerante. Nëse një ish-deputet bëhet lobist në Bruksel, vetëm disa nga privilegjet e tij mund të pezullohen përkohësisht (për periudhën që po zbaton drejtpërsëdrejti një kontratë lobimi).

Sanksionet. Në rastet kur një deputet vepron në kundërshtim me protokollin e konfliktit të interesit, Kryetari i Parlamentit e referon çështjen tek një Komitet i veçantë Këshillimor. Komiteti nga ana e tij zhvillon një hetim të rastit dhe i bën rekomandime Presidentit. Deputeti ka mundësinë të japë shpjegime të mëtejshme mbi shkeljen e përcaktuar të rregullave dhe pastaj Presidenti vendos për vendosjen e dënimit. Sanksionet përcaktohen në Rregulloren për Funkcionimin e Parlamentit Evropian: qortim, mbajtja e pagës për atë ditë, pezullim i përkohshëm nga pjesëmarrja në të gjitha ose disa nga aktivitetet e Parlamentit, pezullimi ose largimi nga një ose më shumë detyra të mbajtura nga Anëtari në Parlament. Personi i dënuar ende ruan të drejtën për të apeluar vendimin. Dënimet e vendosura shpallen dhe publikohen në faqen e internetit të Parlamentit.

Komisioni Evropian

Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative. Komisioni Evropian i rregullon çështjet e interesit, dhuratave dhe mikpritjes në konflikt në udhëzimet e shumta për sjelljen e denjë administrative. Më e rëndësishmja mes tyre është Kodi i Sjelljes së Mirë Administrative. Ndryshe nga Udhëzimet për Parlamentin, Kodi afirmon parimet që duhet zbatohen nga punonjësi i mirë publik dhe nuk përfshihet në detajet e protokollit për të përballuar situatat e konfliktit të interesit:

a) Interesi publik është mbi gjithçka. Interesi i Komuniteteve identifikohet me interesin publik.

- *Komisioni dhe stafi i tij kanë për detyrë t'i shërbejnë interesit të Komunitetit dhe, duke vepruar kështu, interesit publik.*
- *Stafi gjithnjë duhet të veprojë në mënyrë objektive dhe të paanshme, në interes të Komunitetit dhe për të mirën publike*

b) Interesat personale ose politike përjashtohen plotësisht. Këtu mund të bëjmë një pyetje provokative: A nuk është interesi politik i shumicës së votuesve që përcakton politikat e BE-së?

Ata duhet të veprojnë në mënyrë të pavarur në kuadër të politikës së caktuar nga Komisioni dhe sjellja e tyre nuk do të udhëhiqet kurrë nga interesi personal apo kombëtar ose nga presioni politik.

Rregulloret për stafin. Holësi të tjera për rregullat që duhet të ndiqen në rekrutimin dhe aktivitetet e stafit jepen në Rregulloren Nr. 31 (EEC), 11 (EAEC), ku përcaktohen rregullat e stafit dhe zyrtarëve dhe kushtet e punësimit të punonjësve të tjerë të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike:

a) Konfliktet e interesit kontrollohen që në fazën e rekrutimit:

Para se të rekrutohet një zyrtar, autoriteti që rekruton duhet të shqyrtojë nëse kandidati ka ndonjë interes personal të atillë që të dëmtojë pavarësinë e tij ose ndonjë konflikt tjetër interesash. Për këtë qëllim, kandidati, duke përdorur një formular specifik, do të informojë autoritetin rekrutues për çdo konflikt real apo potencial të interesit. Në raste të tilla, autoriteti rekrutues do ta marrë parasysh këtë deklaratë dhe do të japë një mendim të arsyetuar.

(Titulli II, Neni 11)

b) Interesat personale familjare dhe financiare përjashtohen rreptësisht gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Nëse paraqitet një gjë e tillë, punëmarrësi duhet të njoftojë autoritetin punëdhënës dhe duhet të merren masa për të neutralizuar kërcënimin e konfliktit të interesit (neni 11a).

c) Është parashikuar një dispozitë e veçantë për rastin kur punonjësit e lënë Komisionin për të vijuar karrierën në sektorin privat, i cili mund të konsiderohet si përfitues nga kontaktet dhe ekspertiza e tij e mëparshme. Në këtë rast, punonjësi duhet të njoftojë punëdhënësin për të marrë miratimin e tij për çdo zgjedhje personale që mund të krijojë dyshime për favorizimin e interesave private:

Zyrtari, pas largimit nga shërbimi, vazhdon të jetë i detyruar nga detyra që të sillet me integritet dhe kujdes në lidhje me pranimin e emërimeve ose përfitimeve të caktuara. Zyrtarët që synojnë të angazhohen në një aktivitet profesional, qoftë fitimprurës ose jo, brenda dy vjetëve nga largimi nga shërbimi, duhet të informojnë institucionin e tyre duke përdorur një formular specifik. Nëse kjo veprimtari lidhet me punën e kryer nga zyrtari gjatë tre viteve të fundit të shërbimit dhe mund të çojë në konflikt me interesat legjitime të institucionit, autoriteti i emërimit mundet, duke marrë parasysh interesat e shërbimit, ose të mos lejojë që zyrtari të marrë punën e re ose të japë pëlqimin sipas çdo kushti që e mendon të arsyeshëm. Autoriteti punëdhënës, pas konsultimit me

Komitetin e Përbashkët, njofton vendimin e tij brenda 30 ditëve pune nga marrja e njoftimit. Nëse deri në fund të kësaj periudhe nuk është bërë asnjë njoftim i tillë, kjo do të konsiderohet se përbën pranim në heshtje.

(Titulli II, Neni 16)

Zyrtarët e lartë (vendimmarrës) u ndalohet edhe të japin shërbime konsulence apo lobimi gjatë 12 muajve pas largimit nga posti.

Në rastin e ish zyrtarëve të lartë, siç përcaktohet në masat zbatuese, autoriteti punëdhënës, në parim, i ndalon ata, gjatë 12 muajve pas largimit nga shërbimi, të angazhohen në lobim ose avokim kundrejt stafit të institucionit të tyre të mëparshëm në përfitim të biznesit të tyre, klientëve ose punëdhënësve të tjerë për çështjet për të cilat ata ishin përgjegjës gjatë tre viteve të fundit në shërbim. (Po aty.)

Dhuratat dhe mikpritja. Janë hartuar një sërë udhëzuesish specifike për të klasifikuar rregullat për mikpritjen dhe dhuratat për punonjësit e Komisionit Evropian. Edhe pse rregulloret e stafit ndalojnë marrjen e favoreve, dhuratave ose pagesave nga burime të jashtme, në rrethana të veçanta (për shembull, kur zyrtarët nuk janë në shërbim aktiv, duke përfshirë zyrtarët e mëparshëm), lejohen disa dhurata që nuk do të dëmtojnë integritetin e marrësit.

Për efikasitetin e masave paraprake të parashikuara është e rëndësishme të kemi një përkufizim të saktë ku të përkruhet çfarë është “dhurata”. Sipas Udhëzimeve për Dhuratat dhe Mikpritjen (Komunikimi në Komision SEC (2012) 167 final), dhuratë do të thotë:

1) një shumë parash ose çdo send fizik, ose 2) mundësia për të marrë pjesë falas në ngjarje që janë të hapura për publikun ose janë private për nga natyra, janë të aksesueshëm vetëm në këmbim të pagesës dhe përfaqësojnë një vlerë të caktuar (si p.sh. bileta për aktivitete sportive, koncerte, teatër, konferenca, etj.), Ose 3) çdo avantazh tjetër me vlerë monetare, siç janë kostot e transportit.

Sendet me vlerë të vogël (broshura, materiale që lidhen me promocionin dhe reklamën, etj.) nuk konsiderohen nën këtë kategori. E njëjta gjë vlen edhe për dhuratat nga anëtarët e familjes dhe të afërmit e tjerë. Nga ana tjetër, dhuratat, që merren nga palë të treta, pranë zyrtarit, përkufizohen si “dhurata të tërthorta.” Mënyra më e dukshme e dhuratave që duhet të shmanget në çdo rast është paraja. Atëherë, cilat janë rastet kur lejohet të pranohen dhuratat?

Së pari, punonjësit duhet t’i jepet leje nga institucioni punëdhënës (me autorizim). Së dyti, do të konsiderohet në radhë e parë imazhi i institucionit (duke shmangur konfliktin e interesit). Së treti, pranimi duhet të vijë si domosdoshmëri formale nga detyra, siç është mirësjellja sociale ose diplomatike.

Duke marrë parasysh lejen, autoriteti punëdhënës duhet të llogarisë disa konsiderata bazë:

Janë vendosur disa pragje si referencë për zbatimin e procedurës. Për sendet nën 50 euro, rekomandohet miratimi paraprak nga eprori. Dhuratat midis 50-150 eurove kërkojnë një leje të qartë paraprake. Autorizimi për dhurata me vlerë mbi 150 euro duhet të refuzohet automatikisht. Edhe refuzimet nga zyrtari janë subjekt i komunikimit me institucionin e tij mëmë. Refuzimet janë: a) kthimi i dhuratës tek dhuruesi ose b) dhënien e dhuratës për qëllime bamirësie. Njoftimi zyrtar i dhënësit sugjerohet si akt mirësjelljeje.

Rregullimi i mikpritjes ndjek një logjikë pak më të ndryshme. Në përgjithësi, mikpritja është e ndaluar, por ky rregull nuk vlen për pije freskuese, ushqime të thjeshta dhe darka zyrtare.

Gjithsesi, si masë paraprake e preferuar duhet që të merret leje paraprake nga institucioni. Departamentet që kryejnë funksione të ndryshme kanë të drejtë të vendosin kufizime shtesë për zyrtarët e tyre. Në përgjithësi, stafi i Komisionit duhet të ketë gjithmonë parasysh se:

Nuk ta jep kush drekën falas.

ii. Trajtimi i konfliktit të interesit në organe të tjera të BE-së

Ashtu si Parlamenti dhe Komisioni, në të gjithë organet e ndryshme të BE-së janë hartuar udhëzime të ndryshme, sipas kontekstit dhe fushës përkatëse. Kujdes është shprehur veçanërisht në agjencitë përgjegjëse për marrëveshjet e mëdha të prokurimit dhe rregulloreve me biznesin e madh.

Agjencitë e decentralizuara të BE-së janë krijuar për të lehtësuar zbatimin e politikave të BE. Ato mbështesin edhe bashkëpunimin midis Brukselit dhe qeverive kombëtare. Këto organe kryejnë detyra teknike dhe shkencore që lidhen me sektorë të ndryshëm ekonomikë, si ushqimi, siguria, kimikatet, arsimiti, transporti, etj. Që nga 10 dhjetori 2013 janë publikuar Udhëzime të përbashkëta për Parandalimin dhe Menaxhimin e Konfliktit të Interesit. Në këto udhëzime jepen parimet dhe mjetet e përgjithshme që do t'i bëjnë të mundur agjencive të zhvillojnë më tej sistemet e tyre për kontrollin e konfliktit të interesit.

Së pari, udhëzimet përcaktojnë grupet e synuara për procedurat e kontrollit. Këto grupe janë:

- Anëtarët e bordeve drejtuese, bordeve të rregullatorëve dhe bordeve të mbikëqyrësve;
- Ekspertët në komitetet shkencore apo organe të ngjashme që bashkëpunojnë drejtpërdrejt me Agjencinë, por që nuk janë të punësuar nga Agjencia;
- Anëtarët e stafit të agjencive;
- Përfituesit e granteve dhe kontratave të BE-së;
- Ekspertët dhe praktikantët e vendeve të dyta.

Së dyti, udhëzimet japin edhe një përkufizim operacional për “konfliktin e interesit”, i cili përshkruhet si:

Një situatë ku paanshmëria dhe objektiviteti për një vendim, mendim, apo rekomandim i një agjencie është ose mund të perceptohet si i kompromentuar nga interesat personale që ka ose që i besohen një individ të caktuar.

Bëhet një dallim mes interesave të natyrës financiare dhe jo-financiare. Dokumenti fokusohet jo vetëm në pavarësinë aktuale, por deklaron edhe perceptimin e pavarësisë si shumë të rëndësishëm.

Së treti, transparenca inkurajohet tek të gjitha administratat. Ata duhet të miratojnë rregulla të qarta për të ekspozuar dhe neutralizuar situatat e konfliktit të interesit. Drejtuesit, stafi dhe ekspertët janë të detyruar të deklarojnë angazhimet e tyre dytësore përmes deklaratave dhe shpalljes në internet. Vëmendje e veçantë duhet të tregohet dhe rekomandohet gjatë përzgjedhjes së personelit. Këshillohet që e njëjta vëmendje të tregohet edhe gjatë punës me grupin përkatës të ekspertëve. Ndershmëria dhe paanshmëria në procesin e vendimmarrjes janë të rëndësishme për transparencën, prandaj duhet të ndjekin hapa të thjeshta dhe të sigurt, të kuptueshme dhe kontrollueshme për të gjithë aktorët dhe qytetarët. E drejta për ankesë duhet t’u jepet edhe palëve të prekura nga procesi në fjalë.

Së katërtri, duhet të planifikohen masa për të luftuar dhe neutralizuar konfliktet aktuale të interesit. Në pjesën më të madhe të rasteve parandalimi ka të bëjë me kufizimin e pjesëmarrjes në nivele të ndryshme. Në fazat e mëvonshme, kur janë identifikuar shkelje të besimit, duhet të ndërmerren veprime të tjera, të cilat synojnë përmirësimin dhe ndreqjen e situatës. Disa nga këto veprime janë:

- Qortimi
- Anulimi i emërimit
- Dorëheqje/kërkesë për dorëheqje

Së pesti, për të mbajtur sistemin në punë, duhet të kryhet një rishikim i rregullt i politikave të konfliktit të interesit. Ky shqyrtim duhet të bazohet në treguesit e performancës, ku të përfshihen, por nuk kufizohen në: përqindja e deklaratave të konfliktit të interesit, të përpunuara në kohë, numri dhe përqindja e konflikteve të mundshme të zbuluara, numri dhe përqindja e masave ndëshkuese të zbatuara, përqindja e rasteve të shkeljeve të besimit, etj.

Zbatimi i kësaj kornize të përgjithshme me rekomandime mund të evidentohet më tej në praktikën e agjencive të veçanta.

Agjencia Evropiane e Mjekësisë (<http://www.ema.europa.eu/ema/>) është e ngarkuar me vlerësimin shkencor, mbikëqyrjen dhe monitorimin e sigurisë të ilaçeve të zhvilluara nga kompanitë farmaceutike për përdorim në BE. Kjo agjenci ka detyrimin të sigurojë që ekspertët e saj shkencorë, anëtarët e bordit dhe stafi janë të paanshëm gjatë kryerjes së detyrave të tyre. Për secilin grup janë hartuar dispozita të ndryshme e të veçanta. Ekspertët shkencorë i nënshtrohen shqyrtimit sipas deklaratave të tyre të interesit. Plotësimi dhe dorëzimi i deklaratave është i detyrueshëm. Këto deklarata janë të aksesueshëm për publikun në listën e ekspertëve evropianë. Përfshirja e ekspertëve në procedurat e vlerësimit dekurajohet në rastet kur ata planifikojnë të marrin poste pune në industrinë farmaceutike. Roli drejtues ose udhëheqës në zhvillimin e një ilaçi në vendin e mëparshëm të punës çon në përjashtimin e përjetshëm nga përfshirja në vlerësimet për kompaninë apo produktet e saj. Për interesat e tjera të deklaruara është parashikuar një periudhë “ftohjeje” trevjeçare. Në rastet e shkeljes së besimit parashikohet një procedurë e veçantë, e cila mund të çojë në përjashtimin e ekspertit nga komiteti shkencor nëse vërtetohet dyshimet. Për anëtarët e stafit, rregullat parashikojnë që personeli i sapoemëruar të lërë çdo angazhim të mëparshëm që mund të çojë në konflikte interesi. Punonjësit që janë të punësuar me kohë të pjesshme duhet të plotësojnë deklaratat për konfliktet e interesit dhe monitorohen rregullisht. Anëtarët e bordit drejtues i nënshtrohen kontrolleve të ngjashme dhe kur është e nevojshme bëhen subjekt i procedurave që ndërmerren për shkeljen e besimit. Ata plotësojnë dhe dorëzojnë deklarata çdo vit.

Autoriteti Bankar Evropian (EBA) është një organ i pavarur, i cili merret me rregullimin dhe mbikëqyrjen efektive dhe të qëndrueshme të sektorit bankar evropian (<http://www.eba.europa.eu/>). Besimi i publikut është vendimtar për punën e EBA. Politikat e duhura për të parandaluar konfliktin e interesave kanë si synim të mbrojnë paanshmërinë e stafit dhe të anëtarëve të bordit. Qëllimi i këtyre politikave vihet re fare qartë nga emri përshkrues “Politika mbi Pavarësinë dhe Proceset e Vendimmarrjes për Shmangien e Konflikteve të Interesave” (Politika e Konfliktit të Interesit) të miratuar nga Bordi Mbikëqyrës i EBA-s. Këto politika kanë si objekt dhe subjekt pjesëmarrësit e ndryshëm në procedurat e vendimmarrjes dhe kontrollit: anëtarët e bordit të mbikëqyrjes, anëtarët e bordit drejtues, vëzhguesit nga shtetet anëtare. Të gjithë individët në fjalë janë të detyruar të plotësojnë një Deklaratë për Konfliktin e

Interesit, deklaratë që më vonë bëhet publike në internet. Llojet e ndryshme të situatave me konflikt interesi kalojnë nën sitën e kontrollit: interesat ekonomike, anëtarësia në borde e organizata, aktivitete me punëdhënës të tjerë, aktivitete konsulence, të drejta të pronësisë intelektuale dhe interesa të anëtarëve të familjes së ngushtë. Sa herë që shfaqen konflikte interesash, duhet të ndërmerren masa për t'i zbutur ose eliminuar ato. Veçanërisht e ndjeshme në sektorin bankar është mbrojtja e informacionit konfidencial. “Blerja e informacionit nga brenda” konsiderohet si një sjellje tejte e rëndë dhe dënohet ose me masa disiplinore ose me ndjekje penale.

iii) Regjimet kombëtare: rastet e Bullgarisë dhe Shqipërisë

Paragrafët e mëposhtëm japin një panoramë të shkurtër të legjislacionit për konfliktin e interesit në vendet pjesëmarrëse të projektit - Bullgaria dhe Shqipëria. Ato janë një shembull i mirë se si politikatat përkatëse në vende të ndryshme, qofshin këto shtetet anëtare apo kandidatët, ndjekin të njëjtën rrugë, që nxitet në nivel komuniteti.

Legjislacioni që synon konfliktin e interesave në Bullgari. Në vitin 2009, dy vjet pas hyrjes në BE, Bullgaria miratoi një ligj të ri për Parandalimin dhe Deklarimin e Konfliktit të Interesit. Paradigma e tij ishte aq e pazakontë për praktikatat ekzistuese administrative, saqë kur një kontratë e caktuar konsulence e një deputeti të njohur bullgar, e nënshkruar para hyrjes në fuqi të ligjit, u vu nën hetim dhe u çua në gjykatë, çështja u mbyll për arsye se konflikti i interesit është i mundur vetëm kur ekziston një kuadër ligjor që e përshkruan atë.

Ligji për Parandalimin dhe Deklarimin e Konfliktit të Interesit përcakton subjektin e tij kryesor si *një situatë kur personi me post publik ka një interes privat që mund të ndikojë në përmbushjen e detyrave të tij*. Nga ana tjetër, “interesi privat” shpjegohet si *çdo interes që çon në përfitim material ose jo-material për një person, që mban post publik*. Në paragrafët e tjerë të ligjit jepen detaje rreth asaj që përbën “përfitim” - nuk kufizohet vetëm në fitimet monetare, por përfshin një listë të gjerë gjërash, midis të cilave “nderimet”, “privilegjet” dhe favore të ngjashme. Elementi i tretë kryesor i ekuacionit - posti publik - përshkruhet përmes një liste të gjatë pozicionesh në hierarkinë e shtetit si:

- Presidenti dhe Zv. Presidenti,
- gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese,
- Deputetët e Parlamentit,
- ministrat e kabinet qeveritar,
- Avokati i Popullit,
- Prokurori i Përgjithshëm dhe anëtarët e Gjykatës së Kasacionit dhe të Gjykatës së Lartë Administrative,
- Drejtuesit administrativë të rajoneve
- Anëtarët e këshillave bashkiakë
- Kryetarët dhe nënkryetarët e bashkive
- Drejtori i Institutit Kombëtar të Sigurimeve.

Ligji është i strukturuar rreth disa temave, që rregullojnë aspekte të ndryshme të kontrollit mbi konfliktin e interesit: a) Ndalimet për mbajtësit e posteve publike, b) Deklaratat e interesave private, c) Veprimet për parandalimin e konfliktit të interesit, d) Kufizimet pas largimit nga shërbimi civil, e) Komisioni për zbatimin e ligjit, f) Procedura për përcaktimin e konfliktit të interesit dhe masat ndëshkuese.

1. Kufizimet synojnë të zvogëlojnë të gjithë aktivitetin privat të orientuar nga fitimi i mbajtësit të postit publik që mund të vënë në pikëpyetje zbatimin e paanshëm të detyrave të tij.
2. Kërkesa për deklarimin e konfliktit të interesit trajton rastet kur një zyrtar duhet të plotësojë deklaratat: para marrjes së detyrës ose sa herë që shfaqen interesat private.
3. Veprimet për të parandaluar konfliktin e interesave lidhen kryesisht me pezullimin nga detyra dhe refuzimin për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.
4. Për sa i përket kufizimeve është vendosur një afat njëvjeçar pas largimit nga posti, gjatë të cilit vazhdojnë të zbatohen kufizimet për ish-mbajtësit e postit publik.
5. Ligji krijon një administratë të veçantë për t'u kujdesur për zbatimin e tij - Komisioni për Parandalimin dhe Përcaktimin e Konfliktit të Interesit. Ky Komision ka për detyrë të trajtojë të dhënat për situatat e konfliktit dhe të mbajë regjistrin e tyre.
6. Procedura për përcaktimin/zbulimin e konfliktit të interesit përfshin hetimin e plotë të çdo të dhëne dhe sinjali, bazuar në shqyrtimin e dokumentit dhe dëgjimin e personit të akuzuar. Inspektorët institucionalë kryejnë kontrolle fillestare dhe mbledhin dokumentet përkatëse. Dënimet administrative përcaktohen nga Komisioni (shih pikën E). Ato variojnë sipas shumës së gjobave financiare dhe mund të apelojnë.

Përshkrim i ligjit shqiptar

Ligji Shqiptar për Parandalimin e Konfliktit të Interesit i ka fillesat që në prill të vitit 2005. Ashtu si ligji bullgar, edhe ligji shqiptar trajton çështjet e a) përkufizimit të termit, b) grupeve të synuara dhe detyrimit të tyre për të deklaruar situatat e konfliktit, c) procedurën për të identifikuar konfliktet e interesit, zgjidhjen dhe ndëshkimet përkatëse.

1. **Përkufizimet.** Edhe këtu fenomeni shpjegohet si kontradiktë mes detyrës publike dhe interesave private të një zyrtari, të cilat mund ose duket se ndikojnë në kryerjen e përgjegjësive publike. 2. Vëmendje e veçantë i kushtohet idesë së “Kryerjes në mënyrë të drejtë të detyrave dhe përgjegjësive”: ajo lidhet me cilësi të tilla si ndershmëria, përgjegjësia, përkushtimi dhe respektimi i ligjit. Janë disa lloje të konfliktit të interesit: në veçorinë e përmendura - faktik, i dukshëm, i mundshëm, dy lloje të reja konfliktesh: “konflikti rast për rasti interesi” dhe “konflikti i vazhdueshëm i interesit.” Konflikti rast për rast i referohet konflikteve që shfaqen në situata të veçanta vendimmarrëse. Nga ana tjetër, konflikti i vazhdueshëm i interesit i referohet gjendjes, në të cilën konflikti i interesit mund të shfaqet në mënyrë të përsëritur dhe/ose të shpeshtë në të ardhmen. Interesi privat mund të lidhet me pagesat, të drejta pronësore, dhuratat, favoret dhe marrëdhëniet e ndryshme (familjare, intime, fetare).
2. **Deklaratat.** Hapësira, e destinuar për kategorinë “zyrtar”, është e gjerë. Në përfshihet “çdo zyrtar që merr pjesë në vendimmarrje”. Ky zyrtar mund të bëjë pjesë në organet legjislative, gjyqësore, ekzekutive, pavarësisht nivelit, qendror apo vendor.

Identifikimi dhe regjistrimi i situatave të konfliktit të interesave supozohet të kryhet kryesisht me anë të deklaratave të detyrueshme me shkrim. Është një vetë-deklarim rast pas rasti. Informacioni për konfliktet e interesit mund të vijë edhe nga palë të treta, si individët, bazat e të dhënave, regjistrat, mediat etj. Çdo deklaratë regjistrohet dhe arkivohet. Disa kategori zyrtarë (p.sh. zyrtarë të lartë të pastrimit të parave) janë të detyruar të plotësojnë në mënyrë periodike deklaratat. Zakonisht shpeshësia e këtyre vlerësimeve lidhet me ciklin profesional: pas emërimit, me largimin ose me kërkesë të autoriteteve kompetente.

1. **Identifikimi dhe ndëshkimi.** Zbulimi i situatave të konfliktit të interesit është përgjegjësi parësore e zyrtarit në fjalë. Ai është i detyruar të raportojë tek eprorët e tij sapo të ketë një rrezik të tillë. Nga ana tjetër, aparati shtetëror duhet të verifikojë rregullisht informacionin e paraqitur (2/3/4 vjet). Në rast kur informacioni nuk është i mjaftueshëm, mund të nisët një hetim administrativ nga Inspektori i Përgjithshëm.

Për të parandaluar konfliktet e interesit ligji jep përcaktimet e mëposhtme:

- Ndalimi i lidhjes së kontratave (p.sh., kryetari i bashkisë nuk mund të lidhë kontratë me bashkinë e tij);
- Ndalime në sigurimin e të ardhurave për shkak të funksionit të veçantë (p.sh., zyrtari që është aksioner në një kompani nuk mund të marrë përfitime nga aksionet e tij nëse kjo kompani përfiton nga burimet publike);
- Ndalimi i marrjes së dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale,
- Kufizimi i interesave të personave të lidhur me zyrtarin (Rrethi i personave të lidhur me zyrtarin përbëhet nga bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja fëmijët në moshë madhore dhe prindërit e zyrtarit e të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.),
- Edhe për kategori të ndryshme zyrtarësh publike përcaktohen kufizime të veçanta të përshkruara në kategorinë përkatëse në ligj.

Zyrtari, në ushtrimin e funksioneve të tij, paraprakisht, sipas rrethanës, nevojës, në mënyrë të shkallëzuar ose në proporcion me rëndësinë e situatës, mënjanon dhe zgjidh vetë çdo situatë të konfliktit të interesit, të çdo forme qoftë ajo, duke përdorur, sipas rastit dhe përshtatshmërisë, një apo disa nga mënyrat e mëposhtme:

a) duke transferuar a tjetërsuar interesat privatë;

b) duke u vetëpërrjashtuar paraprakisht nga procesi konkret i vendimmarrjes, me përjashtim të rasteve kur është e pamundur delegimi i kompetencave të zyrtarit te një zyrtar tjetër, për shkak të ligjit apo për shkak të situatës ose ne rastet e organit kolegjal, duke mos marrë pjese në diskutimin dhe votimin e çështjes në konflikt.

c) duke dhënë dorëheqjen nga detyrat, funksionet apo angazhimet private, që janë në konflikt me funksionin e tij publik:

ç) duke dhënë dorëheqjen nga funksioni publik, veçanërisht në kushtet e lindjes së konflikteve të vazhdueshme të interesit.

Leksioni 2, Konflikti i Interesit – Organet e specializuara

Vetëm rregullat nuk janë të mjaftueshme për të trajtuar konfliktet e interesit. Për zbatimin e tyre është e domosdoshme të ngrihet një strukturë e autorizuar/e aftë. Kjo gjë duhet të merret parasysh kur mendojmë për OJQ-të vendore si vëzhguese të pavarura për administratën vendore: kontrolli i përshtatshëm i konfliktit të interesit në shërbimin publik është i pamundur pa kapacitetet e mjaftueshme administrative. Kjo do të thotë se organizatat e shoqërisë civile duhet të krijojnë një grup ekspertësh për t'i pasur si mbështetje për përmbushjen e një detyre të tillë. Më poshtë jepen disa shembuj për mënyrën e organizimit të institucioneve publike dhe shoqatave joqeveritare të ngarkuara për të menaxhuar dhe evidentuar konfliktet e interesit.

Komisioni për Parandalimin dhe Përcaktimin e Konfliktit të interesit - Bullgari

Komisioni është një organ kolegjal i pavarur, përfitues kryesor i financimit nga buxheti i shtetit. Ai përbëhet nga pesë persona - kryetari dhe katër anëtarë me mandat pesëvjeçar. Ata kanë të drejta të barabarta dhe nuk mund të zgjidhen për më shumë se dy mandate. Stafit teknik, i organizuar në drejtori (juridike, financiare), jep asistencën operative. Puna e tyre mbikëqyret nga kryesekretari. Pozicione të tjera administrative janë edhe: Kontrollori Financiar dhe Kryeinspektori. Struktura kryen detyrat e mëposhtme:

- Vendos për praninë apo mungesën e konfliktit të interesit
- Mban një regjistër të sinjaleve dhe vendimeve
- Harton formularët e deklaratave
- Jep opinione për çështje që janë brenda fushës së kompetencës së tij.

Çdo vit duhet të hartohet një raport që i paraqitet Parlamentit. Procedimet nisen nga Komisioni mbi bazën e 1) një të dhëne me shkrim, 2) një vendimi të brendshëm, 3) një kërkesë nga një zyrtar publik. Njoftimet anonime nuk pranohen. Rastet mbylLEN me një vendim të arsyetuar.

Është e rëndësishme të sqarohet se parandalimi i konfliktit të interesit mund të mos jetë funksioni ekskluziv i institucionit përgjegjës për të. Për shembull, në Shqipëri, Inspektorati i Lartë për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive është përgjegjës për zbatimin e ligjit për konfliktin e interesit, por po ashtu edhe për procedurat sipas Ligjit për Deklarimin dhe Kontrollin e Pasurive.

Parlamenti i BE-së – Komiteti Këshillimor për Kodin e Sjelljes

Ky Komitet është ngritur në bazë të neneve të Kodit të Sjelljes për Anëtarët e Parlamentit Evropian. Komiteti përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Presidenti “mes anëtarëve të Byrove dhe Koordinatorëve të Komisionit për Çështje Kushtetuese dhe Komisionit për Çështjet Ligjore, duke marrë parasysh përvojën e Anëtarëve dhe balancën politike.” Emërohen edhe anëtarët rezervë. Çdo anëtar vepron si kryetar i Komitetit për një periudhë gjashtëmujore. Ky komitet nuk është organ administrativ i veçantë dhe fusha e veprimit dhe detyrave të tij është e

kufizuar: me kërkesë të deputetit, në afat kohor prej 30 ditësh ata duhet t'i japin atij “udhëzime të besueshme për interpretimin dhe zbatimin e dispozitave të këtij Kodi të Sjelljes.” Një detyrë tjetër e rëndësishme e Komitetit Këshillimor është të hetojë shkeljet e Kodit dhe t'i bëjë rekomandime Presidentit për marrje vendimi për shkelje e hetuara.

Nisma e Organizatave të Shoqëria Civile

Edhe pse evidentimi i situatave të konflikteve të interesit është përgjegjësia kryesore e shtetit, i cili ka në dispozicion burime të mjaftueshme dhe struktura të specializuara, edhe sektori jo-qeveritar mund të ofrojë një gamë modeste instrumentesh për monitorimin e konflikteve të interesit në sektorin publik. Disa shembuj të mirë përmbledhen si më poshtë.

Rusi – Declarator.org

Është një projekt që drejtohet në Rusi nga Transparency International dhe organizata të tjera joqeveritare. Qëllimi kryesor i tyre është të mbajnë një “bazë të dhënash të hapur e të përditësuar vazhdimisht, e cila përmban të ardhura dhe deklarime të pasurive të nëpunësve civilë përfshirë ministra, deputetë, gjyqtarë, si dhe përfaqësues të institucioneve rajonale dhe vendore.” Baza e të dhënave përfshin edhe deklaratat e punonjësve të korporatave dhe kompanive shtetërore. Kjo iniciativë ndihmon në zgjidhjen e çështjes së bërjes publike të deklaratave që duhet të ishin bërë publike, të cilat, gjithsesi, nuk publikohen në një format me strukturë kërkimi dhe të standardizuar.

Gjeorgji – Formati i Deklarimit të të Ardhurave

Në vitin 2013, ekspertët e Transparency International kritikuan faqen e internetit të deklaratave të të ardhurave të Byrosë së Shërbimit Civil, duke pretenduar se të dhënat e kësaj faqeje nuk jepen në një format të përdorshëm. Pra, këto të dhëna dhe deklaratat e tyre jepen në formatin PDF, format që krijon pengesa për analiza dhe kërkim. Për t'iu përgjigjur kësaj sfide aktivistët e OJQ-ve i konvertuan të dhënat nga formati PDF në format dhe tabela Excel dhe i botuan ato në internet në adresën e mëposhtme:

<http://transparency.ge/en/blog/pincome-declarations-scrapep>

Filipine – Kontrolli për stilin e jetesës

Në Filipine një koalicion i OJQ-ve, që punon në bashkëpunim të ngushtë me agjencitë qeveritare, kryen hetime të rregullta për mënyrën se si jetojnë zyrtarët qeveritarë. Qëllimi i këtij kontrolli është të evidentojë nëse shpenzimet e tyre janë në përputhje me të ardhurat e deklaruarat. Objekt shqyrtimi janë edhe interesat e biznesit të politikanëve, pronësia e aksioneve në kompani të ndryshme, konsulencat me pagesë, vendimet e prokurimit si dhe fushatat politike financiare.

Le të bëjmë një përmbledhje. Cilat janë aspektet kryesore të konfliktit të interesit në administratën publike, që mund të trajtohen në mënyrë efektive nga një organizatë joqeveritare (OJQ)?

- Së pari, ne diskutuam për shmangien, që ushqehet nga mungesa e përgjegjshmërisë dhe transparencës: janë marrëdhëniet dhe përfitimet e fshehura ato që “ngarkojnë” situatat e konfliktit. Demaskimi dhe evidentimi i këtyre situatave bie në mënyrë të qartë në fushën dhe gamën e aktiviteteve të OJQ-ve. Kjo gjë mund të arrihet përmes lehtësimit të aksesit tek informacioni: zgjidhja këtu është që transaksionet të jenë të hapura për syrin e publikut. Kjo nënkupton ruajtjen dhe mirëmbajtjen e bazave të të dhënave të pavarura, mbledhjen e informacionit shtesë nga burime të hapura, kërkimin e informacioneve publike, respektimin e ligjeve ekzistuese, etj.

- Së dyti, situata e konfliktit të interesit shfaqet në mjedise që nuk janë rregulluar siç duhet me ligje, kur procedurat e kërkuara nuk aplikohen siç duhet, shkurtimisht - ku administrata është e mangët. Roli i një OJQ-je për të zbutur këtë dobësi lidhet me monitorimin e rregullt e të pavarur të institucioneve, duke raportuar për rreziqet e identifikuara dhe duke dhënë rekomandime për ndryshime ligjore.

- Së treti, kontrolli joefikas i konfliktit të interesit nuk është gjithmonë produkt i një veprimi me synim kriminal. Ky kontroll joefikas mund të jetë si rezultat edhe i mangësive në njohjen e ligjit dhe formave për zbatimin e tij. Organizatat e shoqërisë civile mund të kontribuojnë në zgjidhjen e kësaj sfide duke ofruar ekspertizë të pavarur civile: përhapjen e njohurive se “çfarë është konflikti i interesit” dhe cilat janë mjetet efektive për ta luftuar dhe trajtuar atë.

- Së katërti, në disa raste infiltrimi i grupeve kriminale në aparatit shtetëror është aq i thellë sa përpjekjet në nivelin e rekomandimeve, ekspertizës apo informacionit kanë thjesht efekt zbutës. Këtu është pikërisht vendi ku nevojitet përfshirje më e madhe por edhe më e rrezikshme e shoqërisë civile: veprimtari zbulimi dhe hetimi. Sidoqoftë, është e nevojshme që të tregohet kujdes i madh në këtë drejtim: rreziqet ligjore dhe të sigurisë duhet të merren me seriozitetin më të madh, duke vënë sigurinë personale të stafit në plan të parë.

Kur shqyrtojmë mundësitë për t'u angazhuar në fushën e parandalimit dhe kontrollit të konfliktit të interesave, duhet të kemi parasysh se kjo është një listë treguese e opsioneve të hapura për një organizatë joqeveritare. Faktorët kryesorë për të përcaktuar rrjedhën e veprimit që duhet zgjedhur janë konteksti i vendit si dhe kreativiteti i grupit të punës.

Leksioni 3, Raste studimore

Në paragrafët e mëposhtëm do të përshkruhen disa raste. Në to tregohet si farkëtohen perceptimet dhe përkufizimet e konfliktit të interesit në praktikën reale, të iniciuara për të rregulluar dhe kontrolluar aparatit administrativ.

i. Skandali i parave për ndryshime (ligjesh) [burimi: Observatori i Korporatës Evropiane [1]; Euractiv.com; Euobserver.com]. Në vitin 2012 u miratua një Kod i ri sjelljesh për Parlamentin Evropian, pas një çështjeje, të nxjerrë në dritë nga mediat investigative britanike. Gazetarët e fshehtë nga Sunday Times duke paraqitur si lobiste për klientët e industrisë hynë në kontakt me 60 deputetë të BE. Ata i ftuan ata të bashkoheshin në bordin e një kompanie konsulence të rreme dhe të ndihmonin aktivitetin e saj duke ndikuar në vendimet e parlamentit në favor të klientëve të kompanisë. 14 nga 60 parlamentarë e pranuan marrëveshjen në këmbim të një kompensimi vjetor prej 100,000 €. Videoja, e publikuar nga Sunday Times, tregoi përfaqësuesin rumun Adrian Severin, Ernst Strasser nga Austria, Zoran Thaler nga Sllovenia dhe Pablo Zalba nga Spanja. Kjo 'goditje' çoi në zbulime të mëtejshme rreth praktikave të lobistëve në Bruksel. U zbulua se Strasser kishte në pronësi kompanitë e konsulences CIN dhe CCE Consulting. Ai u punësua nga agjencia austriake e shtypit Hohegger dhe lloboi për ndërmarrje të ndryshme. Midis tyre: Rail Holding dhe Group4Securior, që merreshin me sigurinë e Parlamentit të BE-së. Para kamerës së fshehur Strasser bën rrëfime të mrekullueshme:

"Pikërisht tani kam një mundësi të shkëlqyeshme për të njohur njerëz, për të ndërtuar një rrjet dhe për ta përdorur këtë për kompaninë time ... Natyrisht unë jam lobbist ... Ky është një kombinim shumë i mirë. E shoh atë tani pas një viti: ka shumë njerëz që konkurrojnë dhe kanë nevojë për diçka. Dhe kur dikush është atje si deputet, kjo mund të hapë dyert."

Në fjalët e tij gjejmë shpjegimin e sinqertë përse ai është i gatshëm të merret me lobimin: *pjesa më e madhe e deputetëve janë po aq dembelë sa ç'jam edhe unë.* Më pas vjen sqarimi shtesë se ai tashmë ka 5 klientë të tjerë që po i ndihmon gjatë procesit të vendimmarrjes në Parlamentin Evropian.

Rasti merr edhe një dimension më të thellë, kur gjejmë biografinë e Ernst Strasser. Ai dikur ishte Ministër i Brendshëm i Austrisë gjatë periudhës 2000-2004. Në vitin 2012 ai u përball me gjyqin dhe në vitin 2013 u burgos për një periudhë katër vjet. Kur u pyet nga gjyqtari pse nuk shkoi në polici, nëse dyshonte për marrëveshjen që iu ofrua, përgjigja e Strasser-it ishte se *përvoja e tij si ministër i brendshëm e kishte mësuar të mos besonte.*

Të ngjashme janë edhe citimet nga "konsulentit" rumun, Severin. Ai pretendonte se kjo ishte *një kontratë ligjore. Kemi të drejtë të jemi anëtarë të atyre bordeve këshillimore. Na lejohet të punojmë si konsulentë politikë, detyrimi ynë i vetëm që të mos zbulojmë informacionin konfidencial.* Në vitin 2013 Drejtoria Kombëtare Anti-Korrupsion e Rumanisë paditi Adrian Severin dhe në vitin 2016 ai u dënua me burg nga Gjykata e Lartë e Rumanisë. Zoran Thaler, anëtari slloven i parlamentit dhe një ish ministër i jashtëm i këtij vendi u shpall fajtor nga gjykata në Lubjanë në 2014. Pablo Zalba hodhi poshtë çdo akuzë dhe tani po shërben për një mandat të dytë në Parlamentin Evropian.

ii. *Konflikti në dukje interesi* - Rasti Pat Cox [Burimi: Ombudsmeni Evropian [3]]. Z. Pat Cox, ish-president i Parlamentit Evropian u rizgjodh për tre vjet rresht (2007, 2008, 2009) si këshilltar

special pa pagesë i znj. Meglena Kuneva, atëherë komisionere për Shëndetësinë dhe Politikën e Konsumatorit. Një organizatë joqeveritare, Corporate Europe Monitor, paraqiti një ankesë (letër të hapur për znj. Kuneva) duke thënë se Pat Cox ishte në konflikt të mundshëm interesi: nga njëra anë ai ndikoi në formësimin e politikës së konsumatorit evropian, nga ana tjetër – ai ishte anëtar bordi në disa korporata të mëdha ndërkombëtare dhe në këtë kapacitet u angazhua në lobim për interesin e tyre. Kompanitë e përmendura ishin Pfizer (industria e medikamenteve), Microsoft (industria e teknologjisë së informacionit) dhe Michelin (prodhuesi gomash automjetesh). P. Cox ofroi shërbime konsulence edhe për ndërmarrjen lobuese APCO. Përveç kësaj, ish-zyrtari i lartë dhe këshilltari aktual kishte biznesin e tij të konsulencës - European Integration Solutions (EIS). Ankesa theksoi faktin se në rrethana të caktuara ishte e pamundur të përcaktohej nëse ekziston një konflikt interesi, ndërkohë që nuk kishte informacione të mjaftueshme rreth aktiviteteve të jashtme të këshilltarit në faqen e internetit të Komisionit.

Në sqarimet që pasuan letrën e ankesës, Komisioni dha shpjegime se janë kryer të gjitha kontrollet e nevojshme dhe se nuk është evidentuar asnjë konflikt. Komisioni pohoi gjithashtu se rregullat për konfliktin e interesit nuk aplikohen plotësisht për këshilltarët specialë. Përveç kësaj, këshilltarit i ishte mohuar aksesin tek një pjesë të dokumentacionit përkatës. Në janar 2010 u regjistrua një ankesë tek Ombudsmeni i BE-së dhe u hap një hetim. Në përfundim, ky organ konstatoi se në disa raste (në vitin 2007 dhe 2009) janë kryer akte të keqadministrimit dhe kontrollet e duhura janë kryer si thjesht formalitete. Vendimi thekson ndër të tjera se:

Si përmbledhje, Ombudsmeni shpreh keqardhjen për mënyrën në të cilën Komisioni ka trajtuar procedurën lidhur me emërimin e Z. Cox si Këshilltar Special i Komisioneres Kuneva. Qasja e përgjithshme e Komisionit nuk i përmbahet standardeve gjithnjë e më të larta që qytetarët presin nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe nuk tregojnë respektin e duhur ndaj masave mbrojtëse procedurale të cilat vetë Komisioni i ka hartuar dhe vendosur në përgjigje të shqetësimeve publike për transparencën në lidhje me këshilltarët specialë.

Përveç vërejtjeve kritike të Ombudsmanit, këtu do të citojmë vetë ankesën që jep një përmbledhje unike të çështjes. Edhe pse nuk vë në dyshim integritetin personal të z. Cox, sinjali thekson se qëllimi kryesor i këtij aktiviteti hetimor është *t'i japë fund një mentaliteti që duket se e konsideron si të krejtësisht normale që vendimmarrësit e nivelit të lartë ose këshilltarët e tyre të kanë përfitime paralele me interesat në kompanitë e mëdha.*

iii. *Konsulencë për Projektin e Ujit në Bullgari* [Burimi: Gjykata e Lartë Administrative - Vendimi Nr. 12053 / 18.10.2010, botimet mediatike: econ.bg, legalworld.bg]

Në vitin 2008 z. A. Dogan, udhëheqësi i atëhershëm i një prej partive më të mëdha në Parlamentin bullgar, Lëvizja për të Drejta dhe Liri, u angazhua si konsulent në katër projekte hidroenergjitike për shumën prej 1.5 milion leva bullgare (750,000 euro). Diploma e tij universitare në filozofi dhe karriera e tij politike ngriti dyshime serioze rreth lobimit të interesave pas kësaj kontrate konsulence me një anëtar aktiv të parlamentit. Për më tepër z. A. Dogan punësoi nënkontraktorët për të kryer të gjithë punën shkencore, duke i paguar ata vetëm rreth 25,000 euro. Në vitin 2010, një komision parlamentar mori vendim për të çuar rastin e z. Dogan në Gjykatën e Lartë Administrative. Megjithatë, në tetor 2010 gjykata vendosi që nuk kishte konflikt interesi. Vendimi u protestua dhe procedimet vazhduan në 2011. Në shkurt të vitit 2014, Gjykata më në fund rrëzoi akuzat. Gjyqtarët arsyetuan se politikani nuk ishte në gjendje të ndikonte në procesin e vendimmarrjes. Përveç kësaj, ata vunë në dukje faktin se kontrata ishte

nënshkruar në vitin 2008, ndërsa Ligji për Konfliktin e Interesit hyri në fuqi në vitin 2009, kështu që ligji nuk mund të zbatohet në mënyrë prapavepruese.

iv. Konflikti i interesave në sektorin privat - Goldman Sachs dhe El Paso Corp. [Source: Reuters.com].

Rasti i mëposhtëm ilustron se situata e konfliktit të interesit duket jo vetëm ku postet publike mund të jenë me përfitime për interesat private, por në çdo marrëveshje ku një nga aktorët ka fuqinë për të ndikuar në vendimmarrjen në lidhje me transaksionet e rëndësishme financiare. Reuters tregon historinë e “Goldman Sachs”, e cila në vitin 2012 humbi 12 milionë dollarë në tarifa konsulencë.

Goldman Sachs (GS.N) nuk iu pagua tarifa prej 20 milionë dollarësh e faturës për këshillimin e El Paso Corp në shitjen prej më shumë se 20 miliardë dollarë tek Kinder Morgan Inc (KMI.N), pasi banka e investimeve u akuzua për një konflikt interesi në shitje.

Padia mes aksionerëve të El Paso dhe Kinder Morgan duket se është një shembull i rrallë i një banke investimi që nuk i paguhet tarifa e konsulencës si rezultat i procesit gjyqësor.

Aksionerët e El Paso paditën Kinder Morgan, duke pretenduar se shitja ishte njollosur nga përfshirja e Goldman me të dy kompanitë e energjisë. Ndërkohë që këshillonte El Paso-n, Goldman kishte aksione me vlerë disa miliarda dollarë tek blerësi, kurse bankieri i saj i lartë i energjisë kishte aksione personale me vlerë 340,000 dollarë në kompaninë Kinder Morgan.

Gjykatësi i Çështjeve Tregtare i Kontesë Delaware, Leo Strine, refuzoi të bllokonte marrëveshjen, por kritikoi procesin e negociatave: “Në këtë fazë, nuk mund ta pranoj menjëherë idenë se Goldman nuk do të kërkonte të maksimizonte vlerën e investimit të saj me shumë miliardë dollarë tek Kinder Morgan në kurriz të El Paso, por, në të njëjtën kohë, të jetë kaq i etur për të marrë një tarifë bankare për investime në dhjetëra milionë dollarë,” shkroi Gjykatës Strine.

Reagimi i kompanisë së konsulencës ishte simbolik: **“Goldman Sachs refuzoi të komentonte për këtë çështje.”**